



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E PEJËS MUNICIPALITY OF PEJA OPŠTINA PEĆ

KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër: 400-01/30365, datë: 29 Maj 2025

Në bazë të nenit 11, nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), dhe nenit 24. të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 03/L – 049 për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063, me ligjin Nr. 05/L-007, Ligjit Nr. 08/L-332 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 dhe nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I. Numër: 01-016/01-413431, dt. 30 Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 29 Maj 2025, në propozim të Drejtorisë për Buxhet e Financa dhe kryetarit të Komunës dhe në rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa, merr:

**VENDIM
Nr. 17/2025**

Mbi tejkalimin e planit të hyrave vetanake për vitin 2024 dhe bartjen në vitin 2025

1. **MIRATOHET** tejkalimi i planit buxhetor i të hyrave vetanake për vitin 2024, në shumë prej: 944,848.01 € dhe shpërndarjen e tyre në dy nën programe buxhetore, në kategorinë mallrave dhe shërbime dhe shpenzimeve kapitale, të vitit 2025, si vijon:

- **Mallra dhe shërbime në shume 26,535.70€**
- **Investime kapitale në shume 918,312.31€**

1.1 Në kategorinë mallra dhe shërbime:

Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor (74100) shuma prej 5,347.50
Arsimi Parafillor (92570) shuma prej 21,188.20€

1.2 Në kategorinë e shpenzimeve kapitale, në nën programet:

Infrastruktura Rrugore (18019) në projektet:

“Ujesjellsa për fshatrat e Lugut të Baranit” kodi 85946 në shumë prej 138,850.00€
“Ndertimi i Sheshit Hotel Korze - Ura e zallit” kodi 54629 në shumë prej 183,199.69€
“Ndertimi i Ures së automjeteve Kapeshnicë – Qendër” kodi 54635 në shumë prej 46,083.72 €
“Rindërtimi i rrugëve në Rugovë nga reshqitjet e dheut në fshatrat: Pepaj, Kuqishtë, Boge dhe majën e Zezë “ kodi 54646 në shumë prej 55,929.75€
“Ndërtimi dhe regullimi i hapësirave gjelbruese buzë Lumbardhit dhe në lagjen Asllan Çeshme “ kodi 54657 në shumë prej 190,000.00€
“Ndërtimi, renovimi i rrugëve dhe trotualet në Qendër të qytetit, Lagjet Puhovë, Karagaç, Jarinë, Xh.Kadë, Spitalit, Kristal dhe 7 Shtator “kodi 56142 në shumë prej 248,249.15€
“ Blerja e paisjeve gjeodezike projekte të reja në shumë prej 16,000.€

Arsimi fillor, i mesëm i ulët (93540) ne projektet:

“ Ndertimi i trafos per shk. fillore “ Vaso Pashe Shkodrani “ projekt i ri ne shumë prej 40,000.00

Arsyetim:

Tejkalimi i realizimit i të hyrave mbi plan kërkohet të buxhetohet për mbulimin e mungesave të obligimeve të pa paguar te vitit paraprak, mjete qe mbesin të pa angazhuar shfrytëzohen për realizimin e projekteve te reja të arsyeshme dhe me prioritet.

2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Buxhet e Financa të Komunës së Pejës.

3. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në Web-faqen e Komunës së Pejës

Vendimi ti dërgohet:

MAPL,

DFPT,

Kryetarit të Komunës,

DBF – ca,

Arkivë.

